



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 1044 / Prot  
1

Tiranë, më 10.6.2021

VENDIM

Nr. 29, datë 10.6.2021

PËR

MOSPRAKIMIN E ANKESËS

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 (a) (i) të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesja, znj. I \_\_\_\_\_ ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 1044 Prot., datë 08.06.2021, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Autoriteti Rrugor Shqiptar (në vijim “Autoriteti Publik”).

Me shkresën nr. 50, datë 17.02.2021, ankuesja ka kërkuar nga Autoriteti Publik:

- *Kopje të plotë të kontratës (përfshirë vlerën monetare, datën e fillimit të nënshkrimit si dhe kohëzgjatjen e shërbimit të kontratës) së nënshkruar midis Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe kompanisë kontraktuese “GECI & BIOLIAP”.*

Me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ankuesja ka paraqitur ankesë pranë Komisionerit, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës dhe dokumentacionit bashkëlidhur saj, vërehet se, kërkesa për informacion është depozituar pranë Autoritetit Publik datë 17.02.2021, vërtetuar kjo nga e-mail-in nëpërmjet të cilit është depozituar kërkesa për informacion pranë [info@arrsh.gov.al](mailto:info@arrsh.gov.al).

Pas verifikimit të fakteve dhe bazës ligjore, Komisioneri konstaton se ankesa është paraqitur jashtë afatit ligjor të parashikuar në pikën 2, të nenit 24 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i cili parashikon se: *“Ankimi administrativ pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale bëhet brenda 30 ditëve pune nga dita kur: a) ankuesi ka marrë njoftim për refuzimin e informacionit; b) ka kaluar afati i parashikuar në këtë ligj për dhënien e informacionit”*.

Sa më sipër, rezulton se nuk është përmbushur detyrimi për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit, duke mos plotësuar në këtë mënyrë njërin nga kushtet formale të nevojshëm për marrjen në shqyrtim të ankesave. Mosrespektimi i afatit të ankimit, përbën shkak për mos pranimin e ankesës.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se ankesa e znj. Besnik Dervishi ndaj Autoritetit Publik/Autoriteti Rrugor Shqiptar, është paraqitur përtej afatit të parashikuar në pikën 2 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe si e tillë nuk mund të merret në shqyrtim.

### PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën a), i) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 ‘Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative’ i ndryshuar,

### V E N D O S A:

1. Mospranimin e ankesës nr. 1044 Prot., datë 08.06.2021 të znj. Besnik Dervishi, kundër Autoritetit Publik “Autoriteti Rrugor Shqiptar”, me objekt *“Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”*.
2. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
3. Ky vendim u shpall sot në datë 10 . 6 .2021.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

